

SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

Kolegji Administrative i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej:

Xhezair Zaganjori	Kryesues
Ardian Dvorani	Anëtar
Medi Bici	Anëtar
Tom Ndreca	Anëtar
Admir Thanza	Anëtar

Në datën 12.12.2017 mori në shqyrtim në seance gjyqësore çështjen që ju përket palëve :

PADITËS: Armand Barjami

PADITUR: Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë

OBJEKTI: Anullimin e urdhërit nr. 889 datë 12.11.2013 të ZQRPP Tiranë, rikthimin në vendin e mëparshëm të punës dhe pagimin e pagës për kohën e qëndrimit pa punë.

Detyrimin e palës së paditur për dëmshpërblimin për pushim të padrejtë nga puna me 12 muaj pagë.

Detyrimin për dëmshpërblim për mosrespektim të procedurave të njoftimit të ndërprerjes së punës me 2 muaj pagë dhe 2 muaj dëmshpërblim të tjera.

Detyrimin për dëmshpërblim për shkak të zgjidhjes së kontratës në kohë të papërshtatshme, për shkak të paaftësisë time të përkohshme.

Detyrimin për dëmshpërblime të tjera të mundshme.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 7691 datë 12.07.1995 Kodi i Punës nenet 143, 144, 147, 155 e vijues, nenet 14, 32, 47, 153, 154, 185 të K.Pr.Civile.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjyrokastër, me vendimin nr. 63, datë 19.02.2014 ka vendosur:

Pranimin e pjesshëm të padisë.

Detyrimin e palës së paditur Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, që ti paguajë paditësit Armand Barjami pagën nga data 12.11.2013 deri në datë 31.12.2013.

Detyrimin e palës së paditur Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, që ti paguajë paditësit Armand Barjami një dëmshpërblim prej 2 muajsh pagë për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.

Rrëzimin e kërkesë padisë për pjesën tjetër të objektit të padisë.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1726, datë 13.05.2014 ka vendosur:

Ndryshimin pjesërisht të Vendimit nr. 63, datë 19.02.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër, duke vendosur:

Detyrimin e palës së paditur ZQRPP Tiranë të dëmshpërblej paditësin Armand Barjami me 1 muaj pagë mujore për zgjidhje të menjëhershme të pajustificuar të marrëdhënies së punës.

Lënien në fuqi për pjesën tjetër.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, ka ushtruar rekurs pala e paditur Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë...

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në mbështetje të shkronjës “c” të nenit 63 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”,

V E N D O S I:

Prishjen e vendimit nr. 1726 datë 13.05.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po në atë Gjykatë me tjetër trupë gjyqësore.

Tiranë, më 12.12.2017

Nr. 31001-03665-00-2014 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2017-2420 i Vendimit (880)